




ANALIZA VJETORE 2025


STRUKTURA INSTITUCIONALE

Referuar urdhrit nr.144, datë 01.08.2024 ”Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Agjencisë Kombëtare dhe Drejtorive Rajonale të Arsimit Parauniversitar”, DRAP Fier përbëhet sipas organigramës së paraqitur:



DRAP Fier gjatë vitit 2025 ka plotësuar një pjesë të vendeve vakante në institucion, por ende mbetet pa një specialist të investimeve dhe një specialist jurist.

Me strukturën e re në vitin 2025 filloi funksionimi i sektorit të statistikës, me një seri detyrash që më parë janë mbuluar nga një specialist i vetëm në sektorin e burimeve njerëzore dhe shërbimeve.




Për vitin 2025 ndër prioritetet e punës së DRAP Fier kanë qenë zhvillimi profesional i punonjësve arsimorë, i lidhur ngushtë me kualifikimin e mësuesve dhe identifikimin e nevojave të tyre për trajnim, si edhe aktivizimi i programeve JOM (jashtë orarit mësimor), kryesisht në klubet “Art, zeje dhe sport” pranë shkollave qendra komunitare.

ZHVILLIMI PROFESIONAL I PUNONJËSVE ARSIMORË

Viti 2025 ishte viti i dytë i zbatimit të Programit Kombëtar të Zhvillimit Profesional, me modulet e hartuara nga ASCAP. Trajnimet u zhvilluan nga pedagogët e universiteteve publike të Vlorës dhe Gjirokastrës, për të gjithë mësuesit e profileve “Arsim fillor”, “Gjuhë shqipe dhe letërsi”, “Biologji” dhe “Kimi”, “Matematikë”, “Fizikë”, “Shkenca sociale, Histori dhe Gjeografi” (ky grup përfshihej për herë të parë në program këtë vit), si edhe për drejtuesit e shkollave, punonjësit e shërbimit psikosocial dhe oficerët e sigurisë. Trajnimet u zhvilluan ditëve të premte pasdite dhe të shtunave, pa cenuar procesin mësimor dhe pjesëmarrja për mësuesit dhe punonjësit e këtyre profileve ishte falas. Në ndryshim nga viti i parë i zbatimit të programit, modulet për secilin grup janë trajtuar brenda një fundjave.

Sezoni i trajnimeve filloi në 15-16 mars dhe përfundoi në 12-13 qershor 2025. Ndërlidhur me nevojat e identifikuar gjatë përgatitjes për testimin ndërkombëtar PISA 2025, trajnimi për mësuesit e lëndëve të gjuhës shqipe dhe të shkencave natyrore (fizikë, kimi dhe biologji) u fokusua në zhvillimin e aftësive praktike të tyre për përgatitjen e nxënësve në PISA.

DRAP Fier ka luajtur një rol tepër të rëndësishëm dhe thelbësor në organizimin e trajnimeve në ndihmë të universiteteve, pasi hartoi për çdo seancë listat e mësuesve sipas profileve dhe afërsisë me qendrën e trajnimit. Me ndihmën e ZVAP-ve Lushnjë, Fier dhe Sarandë u realizua hapja e qendrave të trajnimit në mjediset e shkollave, për të lehtësuar pjesëmarrjen e punonjësve arsimorë sa më pranë vendbanimit dhe për të minimizuar në maksimum mungesat për arsye logjistike. Kjo ndërhyrje mundësoi që 42% e mësuesve që u trajnuan nga Universiteti i Vlorës e zhvilluan trajnimin në mjediset e shkollës “Andon Xoxa” Fier, 31% u trajnuan në mjediset e dy shkollave të qytetit të Lushnjës, ndërsa Universiteti “Ismail Qemali” Vlorë priti në mjediset e veta vetëm 27% të mësuesve pjesëmarrës.



DRAP Fier, në bashkëpunim me universitetet, përcaktoi për çdo profil edhe numrin e grupeve për trajnim (34 për Universitetin e Gjirokastrës dhe 105 për Universitetin e Vlorës), ka hartuar kalendarin e zhvillimit të trajnimeve dhe ka ndërmjetësuar në kohë reale me ZVAP dhe monitoruesit e ASCAP-it për të tejkaluar pengesat dhe problematika të ndryshme. Në bashkëpunim me ZVAP-të dhe drejtoritë e institucioneve arsimore parauniversitare publike DRAP ka siguruar njoftimin e mësuesve për seancën e trajnimit dhe ka monitoruar ecurinë e trajnimeve çdo ditë.

Në vitin 2025 u trajnuan prej Universitetit “Ismail Qemali” Vlorë 2188 mësues të ZVAP Vlorë-Himarë, Selenicë dhe të 6 ZVAP-ve në qarkun e Fierit, nga 2712 të planifikuar për trajnim. Niveli i pjesëmarrjes për këtë grup ZVAP-esh është 81%, dukshëm mbi mesataren kombëtare prej 74%.


Prej Universitetit “Eqrem Çabej” Gjirokastrë u trajnuan 529 mësues të qarkut Gjirokastrë, së bashku me mësuesit e ZVAP Finiq-Dropull dhe Sarandë-Konispol-Delvinë, nga 818 të planifikuar gjithsej, ndërsa mesatarja e mësuesve të trajnuar në këto ZVAP ishte në nivel të ulët, 65%, i parafundit në nivel kombëtar.



Në total u trajnuan në modulet e programit kombëtar 2717 mësues, drejtues dhe punonjës arsimorë dhe pjesëmarrja për DRAP Fier ishte 77%, mbi mesataren kombëtare prej 74%.


Niveli i pjesëmarrjes sipas profileve paraqitet në tabelë dhe grafik. Mësuesit e gjuhës shqipe dhe letërsisë e kanë ndjekur më me interes këtë program (pjesëmarrja 83%), pasuar nga mësuesit e arsimit fillor (80%). Vihet re një ndryshim i dukshëm mes frekuentimit prej 80% nga mësuesit e qarkut të Fierit dhe të ZVAP Vlorë-Himarë, ndërsa seancat e trajnimit në Universitetin e Gjirokastrës kanë shënuar pjesëmarrje më të ulët (65%). Niveli i ulët i

pjesëmarrjes në trajnim gjen arsytim të pranueshëm, në përgjithësi mësuesit që planifikoheshin për trajnim në Gjirokastrë, vinin nga zona të largëta të ZVAP Përmet-Këlcyrë ose Tepelenë-Memaliaj, me pak mundësi transporti. Në rastin e profilit “Fizikë” (niveli më i ulët në Universitetin e Gjirokastrës: 48%), kalendari u ndryshua nga ASCAP në ditët e enjte e të premte, më 20-21 mars dhe 27-28 mars, menjëherë pas mësimit, në një kohë kur mësuesit e zonave të largëta nuk mund të siguronin transport për në universitet.



	Arsim i fillor	Gjuhë - letërsi	Matematik ë	Fizikë	Kimi	Biologj i	Shkenca sociale, Histori, Gjeograf i	Drejtue s SHPS of.sig.
Listuar për trajnim	1240	509	434	106	111	238	480	412
Pjesëmarrës	1004	417	309	70	82	179	302	354
	81%	82%	71%	66%	74%	75%	63%	86%





Në raport me qendrat e tjera të trajnimit në vend, frekuentimi i Programit Kombëtar të Zhvillimit Profesional në DRAP Fier është në nivel të kënaqshëm dhe të qëndrueshëm. Problematikat e konstatuara gjatë këtij procesi vlerësojmë se do të tejkalohen gjatë Programit Kombëtar të Zhvillimit Profesional 2026-2028 që pritet të fillojë së shpejti.




Pikë e fortë në këtë proces konsiderohet angazhimi maksimal i ZVAP-ve që siguruan hapjen e qendrave të reja të trajnimit në Fier, Lushnjë dhe Sarandë.

Pika të dobëta evidentojnë mungesa e infrastrukturës digjitale në qendrat e trajnimit në parametrat e kërkuara nga universitetet dhe ASCAP, si edhe listat e pasakta të mësuesve. Kjo e fundit ka qenë një arsye edhe e nivelit më të ulët të llogaritjes së pjesëmarrjes, ndërsa realisht në listat e përditësuara kishte më pak mësues. Pikë e dobët është evidentuar edhe angazhimi i ulët i mësuesve me shkallën e parë të kualifikimit, për t'u trajnuar në ditë pushimi dhe larg vendit të punës.

Ekzistojnë mundësitë për të shmangur problematikat që lidhen me pjesëmarrjen e mësuesve në aktivitete trajnuese duke hartuar lista të sakta, më herët në kohë dhe duke siguruar komunikim të drejtpërdrejtë me ta me qëllim përditësimin e listave në kohë reale.

Mbetet problem mosangazhimi i një kategorie të mësuesve për t'u trajnuar dhe marrë pjesë në aktivitetet e zhvillimit profesional, për shkak të ndërjegjësimit të ulët dhe mospasqyrimit të kësaj mangësie në vlerësimet vjetore nga ana e drejtuesve të institucioneve arsimore.



RRJETET PROFESONALE

Me hyrjen në fuqi të udhëzimit nr. 16 mbi zhvillimin profesional, lidhur me vlerën që u jepet në mikrokredite edhe pjesëmarrjes në takimet e rrjeteve profesionale, si edhe ndryshimeve në rregulloren e funksionimit të institucioneve arsimore parauniversitare, lidhur me detyrimin e drejtorit të IAP-së për monitorimin e punës së drejtuesve të rrjeteve profesionale, rrjetet profesionale janë kthyer në njësi aktive të zhvillimit të brendshëm të kapaciteteve të burimeve njerëzore.


Në vitin 2025 në ZVAP-të e DRAP Fier kanë qenë aktive 264 rrjete profesionale që kanë aktivë 5840 punonjës, një pjesë e të cilëve janë në dy rrjete (drejtues të shkollave, apo mësues që përfshihen edhe në rrjete specifike si ai i braktisjes, etj.).

Rrjetet profesionale të punonjësve arsimorë – viti 2025				
	Numri i rrjeteve	Mësues të përfshirë	Pjesëmarrja në takime mesatarisht për mësues	Nr. i krediteve të fituara nga aktiviteti i rrjetit për çdo mësues
Detyjë	17	459	7.1	1.7
Fier	44	1191	8.0	2.1
Finiq-Dropull	10	107	7.8	2.1
Gjirokastrë-Libohovë	17	325	8.5	2.1
Lushnjë	38	938	7.2	1.8
Mallakastër	13	299	7.6	1.8
Patos	12	235	7.0	1.6
Përmet-Këlcyrë	15	238	7.8	2.0
Roskovec	10	202	6.1	1.6
Sarandë-Konispol-Delvinë	19	390	7.7	1.9
Selenicë	13	253	0.2	0.1
Tepelenë-Memaliaj	17	287	8.4	2.0
Vlorë-Himarë	39	916	8.8	2.1
Total	264	5840	7.1	1.8

	Numri i rrjeteve	Mësues të përfshirë	Pjesëmarrja në takime mesatarisht për mësues	Nr. i krediteve të fituara nga aktiviteti i

				rrjetit për çdo mësues
Divjakë	17	459	7,1	1,7
Fier	44	1191	8,0	2,1
Finiq-Dropull	10	107	7,8	2,1
Gjirokastrë-Libohovë	17	325	8,5	2,1
Lushnjë	38	938	7,2	1,8
Mallakastër	13	299	7,6	1,8
Patos	12	235	7,0	1,6
Përmet-Këlcyrë	15	238	7,8	2,0
Roskovec	10	202	6,1	1,6
Sarandë-Konispol-Delvinë	19	390	7,7	1,9
Selenicë	13	253	0,2	0,1
Tepelenë-Memaliaj	17	287	8,4	2,0
Vlorë-Himarë	39	916	8,8	2,1
	264	5840	7,1	1,8

Vihet re se ZVAP Selenicë ka raportuar më pak takime të rrjeteve profesionale, ndërsa ZVAP Fier, Gjirokastrë-Libohovë, Tepelenë-Memaliaj, Finiq-Dropull kanë pasur aktivitete të qëndrueshëm të rrjeteve të tyre.



Profili i rrjetit profesional	Numri i rrjeteve	Numri mesatar i mësuesve në rrjet
Arsimi fillor	54	25,4
Arsimi parashkollor	22	23,2
Arsimi special	15	30,4
Arte	3	17,0
Biologji, Kimi	24	17,7
Braktisja e fshehtë	5	17,4
Drejtues	3	12,7
Edukim fizik	16	18,7
Ekstremizmi i dhunshëm	1	18,0

Profili i rrjetit profesional	Numri i rrjeteve	Numri mesatar i mësuesve në rrjet
Gjuhë amtare greke	2	16,0
Gjuhë shqipe dhe letërsi	26	22,5
Gjuhë të huaja	25	21,0
Histori, Gjeografi, Shkenca sociale	28	19,1
Matematikë, Fizikë, Informatikë	30	23,7
Mësues mentorë	6	18,7
Mësuesit kujdestar klase	1	27,0
Praktikë profesionale	1	19,0
Shërbimi psikosocial, oficerë sigurie	2	17,5

Nga tabela vihet re se në vitin 2025 nuk janë ngritur masivisht rrjetet e drejtuesve të shkollave, ka vetëm 3 të tillë në ZVAP Përmet-Këlcyrë, Sarandë-Konispol-Delvinë dhe Mallakastër. Megjithatë drejtuesit e shkollave janë përfshirë në rrjetet e tjera, sipas profileve të tyre të mësimdhënies, funksionimi i rrjeteve të posaçme për drejtues IA-je është një mangësi e konstatuar, që do të eliminohet në vijim.

IDENTIFIKIMI I NEVOJAVE PËR ZHVILLIM PROFESIONAL
Studimi i DRAP Fier për tri vitet e fundit (2022-2025)
Punonjësit arsimorë kanë kryer mesatarisht 2,9 trajnime, pra një trajnim në vit.
Numri mesatar i krediteve rezulton në 16 kredite për tri vitet.
589 prej tyre ose 13% nuk kanë asnjë trajnim apo nuk kanë certifikatë me kod të aktivitetit. 3% nuk kanë marrë asnjë trajnim.

IDENTIFIKIMI I NEVOJAVE PËR TRAJNIM DHE ZHVILLIM PROFESIONAL


DRAP Fier gjatë vitit 2025 ka kryer një studim mbi numrin e seancave të trajnimit dhe krediteve që kanë përfituar punonjësit arsimorë në institucionet publike të arsimit parauniversitar në rajon. U morën në shqyrtim të dhënat e grumbulluara nëpërmjet drejtorive të institucioneve arsimore për 4491 mësues dhe punonjës të tjerë, të dhëna që përfshinin periudhën trevjeçare mes viteve 2022-2025. Numri i mësuesve në studim përfshin edhe të larguarit nga sistemi arsimor gjatë periudhës së shqyrtuar. Mbështetur në certifikatat e deklaruara në dosjet individuale që ruhen në çdo shkollë, ku përfshihen trajnime të kryera individualisht ose në kuadër të programit kombëtar të zhvillimit profesional apo aktiviteteve të tjera të agjencive trajnuese publike, rezultoi se punonjësit arsimorë kanë kryer mesatarisht 2,9 trajnime, pra një trajnim në vit. Numri mesatar i krediteve rezulton në 16 kredite për tri vitet. Por jo të gjithë mësuesit kanë kryer këtë detyrim, pasi konstatohet se 589 prej tyre ose 13%

nuk kanë asnjë trajnim apo nuk kanë certifikatë me kod të aktivitetit. Për 3% të tyre deklarohet se nuk kanë marrë asnjë trajnim.


ASCAP ka kryer në vitin 2025, në bashkëpunim me DRAP, një studim më të plotë dhe përfundimtar mbi nevojat e punonjësve arsimorë për zhvillim profesional, i cili është publikuar.

KUALIFIKIMI I MËSUESVE

Në procesin e kualifikimit profesional të mësuesve 2025 u regjistruan 1302 mësues, prej të cilëve 389 për shkallën e tretë të kualifikimit. Përfunduan procesin e kualifikimit gjithsej 1275 mësues, 98% e aplikantëve, pjesa tjetër (2%) nuk u paraqit në testimin e informatizuar ose nuk dorëzoi projektin apo u tërhoq nga zhvillimi i orës së hapur.




Krahasuar me një vit më parë, numri i mësuesve që plotësonin kriteret për kualifikim u rrit ndjeshëm (2,7 herë më tepër), kjo për shkak të uljes së vjetërsisë për përfitimin e shkallëve të kualifikimit. Nuk ka luhatje të ndjeshme të numrit të aplikantëve për shkallën e tretë, në raport me totalin, duke krahasuar dy vitet e fundit (34% në kualifikimin 2024 dhe 30% në kualifikimin 2025).



Në nivel kombëtar mësuesit e rajonit tonë përbënin 21% të të gjithë mësuesve të 5 DRAP-eve që aplikuan për kualifikim në vitin 2025 për të gjitha shkallët, pas DRAP Tiranë dhe Korçë. Por mësuesit që iu nënshtruan testimit të informatizuar në QSHA për shkallën e tretë përbënin

vetëm 30% të numrit të aplikantëve në nivel rajonal. Kjo do të thotë se ZVAP-të e juridiksionit tonë kanë pasur një mbingarkesë të ndjeshme për vlerësimin e orëve të hapura dhe projekteve në mjediset shkollore për 898 mësues, ose 70% të të gjithë mësuesve që aplikuan për shkallën “specialist” dhe “mjeshtër” në të gjithë rajonin (duke u renditur të dytët pas DRAP Korçë për këtë nivel vështirësie).



Në analizë trajtohen kryesisht rezultatet e kualifikimit për shkallën e tretë “mësues i kualifikuar” të nxjerra nga testimi i informatizuar në QSHA, duke qenë se për dy shkallët e tjera mundësia e mbetjes është shumë më e ulët (1% në DRAP Fier dhe Durrës, ndërsa në tre DRAP-et e tjerë për shkallët “specialist” dhe “mjeshtër” është afër 0%).

Krahasuar me numrin e aplikantëve që hynë në testimin e informatizuar për shkallën “mësues i kualifikuar” në vitin 2025 rezulton se mësuesit nga DRAP Fier janë të dytët pas DRAP Tiranë në nivel kombëtar për kalueshmërinë prej 57%. Kjo evidencë ka vlerë vetëm për krahasim në nivelin kombëtar, pasi krahasuar me një vit më parë niveli i mbetjes në testimin e informatizuar ka pësuar regres. Shkaqet e luhatjes së kalueshmërisë në dy vitet e fundit për mësuesit që i nënshtrohen testit të informatizuar, nisur nga pozicionimi në analizën kombëtare, duhet të kërkojnë në përshtatjen e mësuesve të rinj me standardin më të lartë të kualifikimit, si edhe nevojën e tyre për kualifikim. 1/3 e mbetësve në kualifikim i përket mësuesve të arsimit parashkollor që aplikuan për shkallën e tretë. 70% e mbetësve janë mësues të profileve “Arsimi parashkollor” (1/3 e totalit të mbetësve), “Edukimi fizik”, “Arte”, “Gjuhë të huaja”, profile të cilat nuk janë përfshirë në trajnimet e Programit Kombëtar të Zhvillimit Profesional, të dy viteve të fundit. Ky hendek planifikohet të tejkalohet me programin e ri të trajnimeve falas që fillon këtë vit.

Sipas ZVAP-ve të rajonit tonë, kalueshmëria në testimin e informatizuar të kualifikimit 2026 paraqitet si vijon:


ZVAP	% e kalueshmërisë për shkallën III "Mësues i kualifikuar"
LUSHNJË	68%
SELENICË	67%
FIER	64%
FINIQ-DROPULL	64%
ROSKOVEC	64%
DIVJAKË	63%

ZVAP	% e kalueshmërisë për shkallën III "Mësues i kualifikuar"
PËRMET-KËLCYRË	60%
VLORË-HIMARË	54%
MALLAKASTËR	50%
SARANDË-KONISPOL-DELVINË	46%
GJIROKASTËR-LIBOHOVË	43%
PATOS	29%
TEPELENË-MEMALIAJ	22%


Për secilën ZVAP analiza e treguesit të mësipërm duhet të lidhet edhe me profilet e mësuesve që kanë mbetur në kualifikim.

Sipas profileve, mbetësit e testimit të informatizuar për shkallën e tretë të kualifikimit 2025, pasqyrohen në tabelë dhe grafik:

PROFILI i mësuesve mbetës në testimin e informatizuar të kualifikimit 2025	DRAP FIER	NË SHKALLË VENDI
Arsimi parashkollor	34%	28%
Edukim fizik	20%	20%
Gjuhë të huaja	14%	16%
Arsimi fillor	10%	19%
Arsimi special	9%	3%
Arte	2%	1%
TIK	1%	1%
Të tjera	10%	11%
	100%	100%



Për sa u përket niveleve të vlerësimit, evidentohet rritje e dukshme e numrit të mësuesve të kualifikuar “Shkëlqyeshëm” në të tria shkallët, krahasuar me një vit më parë (29% krahasuar me 9% në kualifikimin 2024). Me vlerësimin “Shumë mirë” rezultojnë 63% e mësuesve përkundrejt 49% në kualifikimin e një viti më parë.




Aktiviteti i shkollave qendra komunitare vijon në 12 nga 13 ZVAP-të e rajonit, vetëm ZVAP Finiq-Dropull, për arsye specifike, nuk ka asnjë SHQK. Në përfundim të vitit shkollor 2024-2025 funksiononin si qendra komunitare 103 shkolla, prej të cilave 48 në zona rurale. 52 ishin shkolla 9-vjeçare, 24 shkolla të bashkuara dhe 27 shkolla AML. Në aktivitetet e organizuara prej SHQK-ve deri në qershor 2025 nga 511 klubet e hapura, u regjistruan 9286 nxënës


përfitues, prej të cilëve 328 nga komunitetet rome dhe egjiptiane dhe 162 nxënës me aftësi të kufizuara. U zhvilluan deri në qershor 2025, gjithsej 1121 veprimtari për zhvillimin akademik të nxënësve, 974 veprimtari për zhvillimin artistik, kulturor dhe sportiv të nxënësve, 385 veprimtari për angazhimin dhe mbështetjen e familjes. Sipas ZVAP-ve aktiviteti i SHQK-ve paraqitet në tabelë dhe grafik:

ZVAP	SHQK	Nr.klube	Nxënës pjesëmarrës
Divjakë	11	51	1118
Fier	25	127	1541
Gjirokastër-Libohovë	10	56	1085
Lushnje	14	70	872
Mallakastër	7	34	707
Patos	1	5	70
Përmet-Këlcyrë	5	21	466
Roskovec	6	24	420
Sarandë-Konispol-Delvinë	4	18	753
Selenicë	4	18	231
Tepelenë-Memaliaj	6	36	559
Vlorë-Himarë	10	51	1464
	103	511	9286

NXËNËS PJESËMARRRËS NË AKTIVITETET E SHQK DERI NË QERSHOR 2025



Gjatë vitit 2025 tri shkolla e ndërprejnë aktivitetin si SHQK, pasi njëra prej tyre në ZVAP Gjirokastrë-Libohovë u bashkua me një shkollë tjetër qendër komunitare, një shkollë në ZVAP Vlorë-Himarë u zhvendos për arsye rikonstruksioni dhe u sistemua në turnin e dytë në një SHQK tjetër. Për fillimin e vitit shkollor 2025-2026 u kërkua miratimi nga MAS për dy shkolla të reja si qendra komunitare (1 në ZVAP Lushnjë dhe 1 në Selenicë).



*Programi JOM
(jashtë orarit mësimor)
ART, ZEJE, SPORT*

ZVAP	Shkolla në programin "Art, zeje, sport"	Nr.klubeve
Divjakë	5	15
Fier	14	35
Gjirokastrë-Libohovë	4	14
Lushnje	3	8
Mallakastër	2	8
Patos	1	1
Përmet-Këlcyrë	4	9
Roskovec	4	11
Selenicë	1	4
Tepelenë-Memaliaj	1	1
Vlorë-Himarë	5	18

ART, ZEJE DHE SPORT

Ky program passhkollor ose JOM (jashtë orarit mësimor) filloi të zbatohet për herë të parë në vitin 2022 në 200 shkolla në të gjithë vendin, 44 prej të cilave në rajonin e DRAP Fier. Deri në qershor 2025 veprimtaritë dhe klubet në kuadër të këtij programi kanë qenë miratuar për 11 ZVAP të vartësisë së DRAP Fier, jashtë këtij programi kishin mbetur ZVAP Sarandë-Konispol-Delvinë dhe ZVAP Finiq-Dropull.

ZVAP	Shkolla në programin "Art, zeje, sport"	Nr.klubeve
Divjakë	5	15
Fier	14	35
Gjirokastrë-Libohovë	4	14
Lushnje	3	8
Mallakastër	2	8
Patos	1	1
Përmet-Këlcyrë	4	9
Roskovec	4	11
Selenicë	1	4
Tepelenë-Memaliaj	1	1
Vlorë-Himarë	5	18

Numri i klubeve sipas fushave të programit paraqitet në tabelë dhe diagram:



Vihet re lehtësisht se në shkollat ku zbatohet programi JOM “Art, zeje dhe sport”, nxënësit kryesisht marrin pjesë në klubet e teatrit, zejeve tradicionale, teknologjisë (ku nënkuptohet TIK), piktura. Më pak klube ka në fushat e bujqësisë, muzikës (vegla muzikore dhe kor).

MATURA SHETËTORË 2025			
ZVAP	QENDRA MSH 2025	MATURANTË MSH 2025	MATURANTË PËR QENDER
DIVIAKË	2	224	112
FIER	8	1213	152
FINIQ-DROPULL	2	143	72
GJIROKASTËR-LIBOHOVË	3	331	110
LUSHNË	4	600	150
MALLAKASTËR	1	175	175
PATOS	1	112	112
PËRMET-KËLCYRË	2	119	60
ROSKOVEC	1	176	176
SARANDË-KONISPOL-DELVINË	2	405	203
SELENICË	1	58	58
TEPELENË-MEMALIAJ	1	131	131
VLORE-HIMARË	6	1095	183

KONKURSI KOMBËTAR I GJUHËS SHQIPE
Shkollat finaliste në nivel rajonal
Shkolla 9 vjeçare "Ismail Qemali" Vlorë
Shkolla 9 vjeçare "Naim Frashëri" Gjirokastrë
Shkolla e bashkuar "Mihal Nako" Fier-Seman
Shkolla 9 vjeçare "Andon Xoxa" Fier

KONKURSI KOMBËTAR I GJUHËS SHQIPE

Prej disa vitesh në mbarë sistemin arsimor zhvillohet konkursi i gjuhës shqipe me nxënësit e klasave të nënta, i cili prej vitit të kaluar shoqërohet edhe nga olimpiada e përbashkët e gjuhës Shqipëri-Kosovë. Në vitin 2025, konkursi kombëtar i gjuhës shqipe mbante titullin “gjuha shqipe dhe komunikimi qytetar në epokën digjitale”. Në përfundim të fazave të para të

konkursit të gjuhës shqipe, si edhe të rivlerësimit nga DRAP Fier në një rast kur dy skuadra u paraqitën me pikë të barabarta, rajoni ynë u përfaqësua në nivel kombëtar me 4 skuadrat finaliste nga shkollat 9-vjeçare "Flatrat e Dijes" Fier, "Foto Puka" Lushnjë, "Adem Sheme" Sarandë dhe "Meleq Gosnishti" Patos.

MATURA SHTETËRORE 2025

Analiza fokusohet në sesionin e parë të Maturës Shtetërore, për shkak të peshës që zë në të gjithë procesin dhe efekteve që pasojnë pjesëmarrjen dhe rezultatet e maturanëve në këtë fazë. Meqenëse DRAP nuk ka njësi të strukturuar si komisionet e Maturës Shtetërore në ZVAP, por është angazhuar plotësisht në monitorimin e provimeve, në analizë do të trajtohet kryesisht organizimi i tyre dhe zbatimi i rregullores.

Në të 13 ZVAP-të e DRAP Fier provimet e sesionit të parë të Maturës Shtetërore u zhvilluan në 34 qendra provimi, shumica prej të cilave plotësonin kriteret e vendosura në rregullore dhe udhëzimet e Komitetit të Maturës Shtetërore, të tilla se shfrytëzimi i hapësirave më të mëdha, palestrave dhe korridoreve në shkollat – qendra provimi, si edhe mjediseve të pajisura me kamera. Në këto qendra u sistemuan 4782 maturanët e 113 shkollave të arsimit të mesëm të lartë në juridiksionin e DRAP Fier. Në një ZVAP sesioni i parë i Maturës u zhvillua në një mjedis të vetëm, në kompleksin sportiv të qytetit të Tepelenës, krejtësisht të kontrollueshëm nga administratorët. Në 4 ZVAP të tjera (Roskovec, Patos, Selenicë dhe Mallakastër) provimet u zhvilluan në një qendër të vetme, mjedis shkollor, në secilën prej tyre, e mjaftueshme për numrin e vogël të maturanëve. Ndërsa në dy ZVAP (në Përmet-Këlcyrë dhe Finiq-Dropull), pavarësisht numrit shumë të vogël të maturanëve, për shkak të largësisë së konsiderueshme dhe vështirësisë në transport, për zhvillimin e provimeve u hapën nga dy qendra në secilën prej tyre. Raporti mes numrit të qendrave dhe nxënësve paraqitet në tabelë dhe grafik.

ZVAP	QENDRA MSH 2025	MATURANTË MSH 2025	MATURANTË PËR QENDËR
DIVJAKË	2	224	112
FIER	8	1213	152
FINIQ-DROPULL	2	143	72
GJIROKASTËR-LIBOHOVË	3	331	110
LUSHNJË	4	600	150
MALLAKASTËR	1	175	175
PATOS	1	112	112
PËRMET-KËLCYRË	2	119	60
ROSKOVEC	1	176	176
SARANDË-KONISPOL- DELVINË	2	405	203
SELENICË	1	58	58
TEPELENË-MEMALIAJ	1	131	131
VLORË-HIMARË	6	1095	183



Nga monitorimet e kryera, raportimet e administratorëve dhe të QSHA, rezulton kjo tablo për secilin nga provimet e qershorit 2025:

MATURA SHTETËRORE 2025

Maturantë të përjashtuar nga provimi	Gabime nga maturantët	Gabime nga administratorët
0	5	3
1	4	0
0	1	1
1	1	1

Pjesëmarrja	
Gjuhë e huaj D3	98,70%
Gjuhë shqipe dhe letërsi	98,70%
Matematikë	98,40%
Lëndë me zgjedhje	98,10%

Në provimin e gjuhës së huaj (D3, data 3 qershor) në të gjitha qendrat e provimeve të DRAP Fier morën pjesë 98,7% e maturantëve që kishin të drejtën e pjesëmarrjes. DRAP Fier renditet i treti në 5 DRAP-et për pjesëmarrjen. Nuk pati asnjë të përjashtuar nga provimi dhe asnjë rast të gjetjes së celularëve në mjedis provimi. U konstatuan 5 raste të dëmtimit të testit nga maturantët dhe 3 raste gabimi nga administratorët. Për administrimin e këtij provimi u angazhuan 570 punonjës arsimorë.

Në provimin e gjuhës shqipe dhe letërsisë (D1, data 10 qershor) morën pjesë 98,7% e maturantëve. Për pjesëmarrjen e lartë në këtë provim DRAP Fier renditet i dyti pas DRAP Tiranë. Pati një maturant të përjashtuar nga provimi për mbajtje celulari (në ZVAP Lushnjë) ndër 7 gjithsej në të gjithë vendin. U konstatuan 4 raste të dëmtimit të testit nga maturantët dhe asnjë gabim nga administratorët. Në administrim u angazhuan 563 punonjës arsimorë.

Në provimin e matematikës (D2, datë 17 qershor) pjesëmarrja ishte 98,4% dhe DRAP Fier renditet i treti ndër 5 DRAP-et. Nuk pati asnjë të përjashtuar nga provimi nga 16 të përjashtuar në DRAP-et e tjera. Dëmtim aksidental të testit pati vetëm në një rast. Për administrimin u angazhuan 571 punonjës arsimorë. U konstatua vetëm 1 rast gabimi nga një administrator provimi.


Në provimin me zgjedhje (LZ, datë 24 qershor) DRAP Fier u rendit përsëri i treti në vend për pjesëmarrjen me 98,1%. Gjatë provimit u përjashtua 1 maturant për mbajtje celulari (ZVAP Vlorë-Himarë), nga 9 raste të tilla në të gjithë vendin. 1 maturant dëmtoi testin, ndërsa u konstatua 1 rast gabimi nga administratorët. Për administrimin e këtij provimi u angazhuan 626 punonjës arsimorë.

	Pjesëmarrja
Gjuhë e huaj D3	98,70%
Gjuhë shqipe dhe letërsi	98,70%
Matematikë	98,40%
Lëndë me zgjedhje	98,10%

Maturantë të përjashtuar nga provimi	Gabime nga maturantët	Gabime nga administratorët
0	5	3
1	4	0
0	1	1
1	1	1

Nga përqasja me të dhënat në shkallë vendi, arrijmë në përfundimin se në përgjithësi administrimi dhe monitorimi i provimeve të Maturës Shtetërore 2025 në DRAP Fier janë kryer me korrektesë dhe përgjegjshmëri, duke shënuar përmirësim

Rezultatet e provimeve janë objekt i analizave të institucioneve arsimore, të ZVAP-ve dhe pasqyrohen në mënyrë të detajuar në raportin e Maturës Shtetërore 2025 që hartohet nga QSHA.



MEDALJET E ARTA 2024-2025

I lidhur ngushtësisht me rezultatet në provimet e Maturës Shtetërore 2025, por jo vetëm me to, është edhe nderimi që u bëhet çdo vit maturantëve të shkëlqyer që meritojnë dhe marrin “Medaljen e Artë” nga Kryeministri. Në vitin 2025 nga rajoni i DRAP Fier këtë titull e

fituan 27 maturantë nga Fieri, Patosi, Lushnja, Finiqi, Saranda dhe Vlora, 11 prej të cilëve nga shkolla publike të arsimit të mesëm të lartë.

Suksesi i këtyre të rinjve i atribuohet sigurisht intelektit, përpjekjeve dhe punës individuale të gjithsecilit, por nuk duhen harruar edhe shkollat – mjedisi ku ata morën dije dhe krahë drejt tempullit të dijes. Është domethënëse fakti që 23 prej tyre aktualisht ndjekin studimet universitare në Shqipëri, 19 janë studentë në universitetet publike, megjithëse gjysma e tyre dolën medalistë nga gjimnaze private.

Gjimnazi Privat "Flatrat E Dijes", Fier

Gjimnazi Jopublik "Frymë Dashurie", Mesopotam - Finiq, Finiq

Gjimnazi "18 Tetori", Lushnje

Shkolla e Bashkuar "Dhimitër Mino", Bubullimë, Lushnje

Shkolla e Bashkuar Gorre, Lushnje

Shkolla e Mesme e Përgjithshme Jopublike, Gjinnazi "Dituria", Lushnje

Shkolla e Mesme e Përgjithshme e Profilizuar "Nënshkruesi I Pavarësisë Nebi Sefa", Lushnje
 Gjimnazi "Zhani Ciko", Patos
 Gjimnazi "Hasan Tahsini", Sarandë
 Gjimnazi "Sulejman Delvina", Delvinë
 Gjimnazi "Ali Demi", Vlorë
 Shkolla Jopublike e Mesme e Përgjithshme "Drita E Dijes", Vlorë

OLIMPIADAT KOMBËTARE 2024-2025				
Raporti mes fituesve të dalë nga faza në nivel ZVAP-je, krahasuar me numrin e pjesëmarrësve në olimpiadat kombëtare të viteve 2023-2024 dhe 2024-2025 (vetëm kur ka fitues në nivel kombëtar)				
Lënda ku ka fitues në fazën finale në olimpiadat kombëtare	Olimpiadat 2023-2024	Olimpiadat 2024-2025	Fitues në fazën finale – viti 2024	Fitues në fazën finale – viti 2025
Matematikë AML	1%	1%	1	1
Fizikë	3%	1%	1	0
Kimi	6%	3%	1	0
Biologji	11%	4%	1	1
Informatikë	14%	0%	1	
Gjuhë shqipe dhe letërsi	36%	43%	1	3

OLIMPIADAT KOMBËTARE 2024-2025

Olimpiadat kombëtare 2024-2025 kanë ruajtur në përgjithësi performancën e viteve të kaluara dhe traditës së fituesve në fazën e tretë për shkollat e ZVAP Fier, Vlorë-Himarë. Krahasuar me një vit më parë janë reduktuar lëndët ku shfaqen fituesit në nivelin kombëtar nga shkollat tona; në vitin 2023-2024 në fazën finale ka pasur fitues nga rajoni ynë në të gjitha lëndët STEM, krahas gjuhës shqipe dhe letërsisë. Për të kuptuar cilësinë reale të vlerësimit të nxënësve pjesëmarrës në fazën e dytë, në nivel ZVAP-je, kemi studiuar raportin mes fituesve të dalë nga faza në nivel ZVAP-je, krahasuar me numrin e pjesëmarrësve në olimpiadat kombëtare të viteve 2023-2024 dhe 2024-2025 (vetëm kur ka fitues në nivel kombëtar). Në raportet mes fituesve të fazës së dytë krahasuar me pjesëmarrësit, përqindja e fituesve që garojnë më pas në nivel kombëtar është në tendencë uljeje. Vihet re se një numër më i kufizuar i fituesve në nivel ZVAP-je, ndikon drejtpërdrejt edhe në numrin e nxënësve fitues në nivelin kombëtar.

Raporti mes fituesve të dalë nga faza në nivel ZVAP-je, krahasuar me numrin e pjesëmarrësve në olimpiadat kombëtare të viteve 2023-2024 dhe 2024-2025 (vetëm kur ka fitues në nivel kombëtar)

Lënda ku ka fitues në fazën finale në olimpiadat kombëtare	Olimpiadat 2023-2024	Olimpiadat 2024-2025	Fitues në fazën finale – viti 2024	Fitues në fazën finale – viti 2025
Matematikë AML	1%	1%	1	1
Fizikë	3%	1%	1	
Kimi	6%	3%	1	
Biologji	11%	4%	1	1
Informatikë	14%	0%	1	
Gjuhë shqipe dhe letërsi	36%	43%	1	3

SHËRBIMI PSIKOSOCIAL

Gjatë vitit 2025 në DRAP Fier kanë ofruar shërbimin e tyre 61 psikologë shkollorë, 41 punonjës socialë dhe 3 supervizorë dhe 1 drejtues njësie në nivel rajonal. Gjithsej 105 punonjës psikosocialë.

SHËRBIMI PSIKOSOCIAL

Në zbatim të “Udhëzuesin Për Praktikën e Punës së Shërbimit Psiko- Social Shkollor” ka funksionuar edhe Shërbimi Psiko-Social; duke u kujdesur edhe më shumë për krijimin e vlerave dhe të kulturave gjithëpërfshirëse në brezat e ardhshëm, si edhe duke u fokusuar në rritjen e cilësisë së procesit të mësimnxënies dhe mësimdhënies dhe në përqsajen e sistemit tonë arsimor me sistemet bashkëkohore. Për të siguruar një shërbim psiko-social sa më efektiv, gjatë vitit 2025 në DRAP -Fier kanë ofruar shërbimin e tyre 61 psikologë shkollorë, 41 punonjës socialë dhe 3 supervizorë dhe 1 drejtues njësie në nivel Drap -i . Gjithsej: 105 punonjës psiko-socialë.

Në këtë kuadër janë realizuar prezantimet e SHPS në shkolla, që nxënësit të njohin dhe të orientohen drejt një shërbimi psiko–social bashkëkohor; të njihen me rolin dhe funksionin e SHPS; duke pasur parasysh edhe faktin që ata përballen me shumë ndryshime si: shoqëria, mjedisi shkollor, familja, etj. Për këtë qëllim janë shpërndarë edhe broshurat e informacionit të SHPS. Janë realizuar prezantimet me senatorët e shkollës, me qëllim koordinimin dhe rritjen e mëtejshme të bashkëpunimit për organizimin e veprimtarive të ndryshme. Ky prezantim është fokusuar veçanërisht tek krijimi i grupeve bashkëmoshatare, për të nxitur realizimin e ushtrimeve për rritjen e vetëbesimit, për të mësuar rreth procesit të inkurajimit dhe si adoleshentët mund ta zhvillojnë inkurajimin në marrëdhëniet e tyre shoqërore; duke e ditur çfarë përfaqëson dhe se si mund t’i ndihmojë ky shërbim të kapërcejnë vështirësi dhe sfida të ndryshme. Në çdo shkollë është realizuar Harta Sociale e cila ka për qëllim krijimin e një pasqyre të dhënash për çdo klasë lidhur me: identifikimin e nxënësve me vështirësi dhe probleme të ndryshme sociale, ekonomike, emocionale, nxënës me nevoja të veçanta, vështirësi në të nxënë. Mbledhja e informacioneve është bërë duke kontaktuar me mësuesit kujdestarë të çdo klase dhe drejtorinë e shkollës.

SHËNDRI PERSONAL			
Tregues ekonomikë dhe familjarë		Përkatësia komunitare	
Nxënës nga familje me ndihmë ekonomike	2474	Nxënës nga komuniteti Rom	664
Nxënës jetimë (kanë humbur të dy prindërit)	36	Nxënës nga komuniteti Egjiptian	912
Nxënës që kanë humbur njërin prind	807		
Nxënës me prindër të divorcuar	200		
Nxënës nën përkujdesje institucionale	56		
Potencial dhe mobilitet		Sjellja dhe rreziqet sociale	
Nxënës të talentuar	2633	Nxënës me probleme të sjelljes	209
Nxënës të kthyer nga emigracioni	134	Nxënës që përdorin duhanin, alkoolin etj.	101

1. Tregues ekonomikë dhe familjarë

- Nxënës nga familje me ndihmë ekonomike: 2,474
- Nxënës jetimë (kanë humbur të dy prindërit): 36
- Nxënës që kanë humbur njërin prind: 807
- Nxënës me prindër të divorcuar: 200
- Nxënës nën përkujdesje institucionale: 56

2. Përkatësia komunitare

- Nxënës nga komuniteti Rom: 664
- Nxënës nga komuniteti Egjiptian: 912

3. Sjellja dhe rreziqet sociale

- Nxënës me probleme të sjelljes: 209
- Nxënës që përdorin duhanin, alkoolin etj.: 101

4. Potencial dhe mobilitet

- Nxënës të talentuar: 2,633
- Nxënës të kthyer nga emigracioni: 134

c. Përfaqësimi në komisionet shkollore

Në shkolla funksionon sipas dispozitave ligjore Komisioni shkollos për vlerësimin e fëmijëve me aftësi të kufizuara dhe Task– Force për problemet e dhunës në shkollë, përbërja e të cilave është publikuar në mjediset e shkollës. Në përputhje me udhëzimin e fillim vitit në çdo shkollë është ngritur ekipi antibullying për rastet e bullizmit.

SHËRBIMI PSIKOSOCIAL

Për të zgjidhur probleme të caktuara janë realizuar këshillime individuale dhe në grup.

- vetëbesimi/vetëvlerësimi:
 - vështirësia në të nxënë
- këshillim në orientimin e karrierës:
- menaxhimi i stresit dhe i ankthit:
 - ankthi social
 - mungesa e interesit ndaj mësimave
 - marrëdhëniet midis bashkëmoshatarëve
 - marrëdhëniet mësues – nxënës
 - problemet e sjelljes
 - menaxhimi i emocioneve
 - Ofrimi i mbështetjes psiko-emocionale para testimit

Për të zgjidhur probleme të caktuara janë realizuar këshillime individuale dhe në grup.

Tematikat e këshillimeve të trajtuara përfshijnë kryesisht :

- vetëbesimi/vetëvlerësimi:
- vështirësia në të nxënë
- këshillim në orientimin e karrierës:
- menaxhimi i stresit dhe i ankthit:
- ankthi social
- mungesa e interesit ndaj mësimave
- marrëdhëniet midis bashkëmoshatarëve
- marrëdhëniet mësues – nxënës
- problemet e sjelljes
- menaxhimi i emocioneve
- Ofrimi i mbështetjes psiko-emocionale para testimit

SHËRBIMI PSIKOSOCIAL

Gjatë vitit 2025 janë realizuar në total:

- 3887 këshillime individuale me nxënës
- 1593 këshillime individuale me mësues
- 1051 këshillime individuale me prindër


Gjatë këtij viti 2025 janë realizuar në total:

- 3887 këshillime individuale me nxënës
- 1593 këshillime individuale me mësues

- 1051 këshillime individuale me prindër

Tematikat kryesore kanë përfshirë vetëvlerësimin, vështirësitë në të nxënë, orientimin e karrierës, menaxhimin e stresit dhe ankthit, marrëdhëniet shoqërore, problemet e sjelljes dhe mbështetjen emocionale.

Janë zhvilluar gjithashtu tema psiko-sociale mbi bullizmin, diskriminimin, barazinë gjinore, përdorimin e internetit, drogat, aftësinë e kufizuar, adoleshencën dhe vullnetarizmin.



Nxënësit me AK të vlerësuar nga Komisionet Multidisiplinare

Gjatë vitit 2025, në nivel DRAP Fier janë vlerësuar nga Komisionet Multidisiplinare 819 nxënës, prej të cilëve:

- 233 janë femra,
- 586 janë meshkuj.

Femrat përbëjnë rreth 28% të numrit total të nxënësve të vlerësuar.

- Në kuadër të bashkëpunimit me stafin pedagogjik janë realizuar diskutime me nxënësit si pjesë e temave të përfshira në planet edukative të klasave.
- Me mësues të ndryshëm janë zhvilluar takime dhe konsultime në lidhje me tematika në përputhje me problematikat dhe kërkesat e tyre.
- Me mësuesit ndihmës janë zhvilluar takime dhe konsultime mbi ecurinë e fëmijëve me nevoja te veçanta, vështirësitë që hasin gjatë punës së tyre, komunikimi prind-fëmijë-mësues ndihmës, hartimi i planeve PEI, organizimi i aktiviteteve ditore për përmbushjen e objektivave etj.
- Takime me komisionin shkollor që identifikon dhe monitoron fëmijët me aftësi të kufizuara.

- Rritja e kapaciteteve shkollore në identifikimin, pritjen dhe ofrimin e shërbimeve më cilësore për fëmijët me aftësi të kufizuara në shkollat dhe klasat gjithëpërfshirëse.
- Trajnime me stafin pedagogjik mbi: zhvillimet tipike moshore, mbrojtjen e të dhënave personale, identifikimi i vështirësisë në të nxënë, menaxhimi i stresit dhe ankthit.
- Në përmbushje të detyrave të planifikuara, në bashkëpunim me mësueset e qytetarisë, psikologjisë dhe të edukimit për karrierë, është realizuar testi i orientimit të karrierës për nxënësit maturantë; si dhe pyetësorë për nxënësit e klasave të IX-ta dhe të XII-ta, me qëllim që nxënësit të kenë më të qartë përcaktimin e interesave dhe të faktorëve që ndikojnë në zgjedhjen e karrierës së ardhshme.

Bashkëpunimi me qeverinë e nxënësve është i nevojshëm për koordinimin dhe sensibilizimin mbi çështje të ndryshme. Gjatë vitit shkollor janë realizuar disa takime të cilat kanë pasur si synim përmirësimin e qëndrimeve shoqërore; për eliminimin e stereotipeve që inkurajojnë pabarazinë gjinore në shkollë; por edhe për të nxitur edukimin bashkëmoshatar për të sensibilizuar shoqërinë lidhur me dukuri të tilla si : trafikimi i qenieve njerëzore, ekstremizmi i dhunshëm, diskriminimi .

Janë zhvilluar takime individuale me prindër si dhe takime në bazë shkolle. Takime individuale me prindër janë zhvilluar, sa herë është parë e nevojshme në drejtim të marrëdhënieve prind – fëmijë , mbarëvajtjes mësimore të fëmijëve në shkollë, mbrojtjes së fëmijëve: komunikimi në familje, varësia nga interneti, rezultatet e ulëta në mësimet etj.

**INSPEKTIMI DHE MONITORIMI
I SISTEMIT ARSIMOR
2025**

INSPEKTIMET

Të dhëna të përgjithshme mbi numrin e monitorimeve/vlerësimeve dhe inspektimeve në arsimin bazë, të mesëm të ulët dhe në arsimin parashkollor, për vitin 2025.

Drejtoria Rajonale e Arsimit Parauniversitar (DRAP) ka zhvilluar veprimtarinë e saj, duke zbatuar planin vjetor mbështetur në prioritetet e MA dhe në metodologjinë e Inspektoratit të Përgjithshëm.

Spektori i inspektimit për arsimin bazë dhe për arsimin e mesëm të lartë për vitin 2025 ka zhvilluar funksionet e tij vlerësuese dhe inspektuese me tematika si:

- Inspektim i Zyrove Vendore të Arsimit Parauniversitar (ZVAP), për masat e marra për arsimimin e fëmijëve me aftësi të kufizuara. **(5 ZVAP)**
- Inspektime mbi zbatimin e ligjshmërisë në procedurën e ndjekur nga ZVAP për masat e marra për organizimin e praktikës profesionale për profesionin e rregulluar të mësuesit. **(3 ZVAP)**
- Inspektime mbi zbatimin e ligjshmërisë në procedurën e ndjekur nga IAP-të për masat e marra për organizimin e praktikës profesionale për profesionin e rregulluar të mësuesit. **(3 IAP)**
- Inspektim i institucioneve arsimore publike parauniversitare për numrin e nxënësve për klasë dhe ngarkesën mësimore të punonjësve arsimore në IAP. **(16 IAP)**
- Inspektim i institucioneve arsimore publike parauniversitare për përzgjedhjen, shpërndarjen dhe shitjen e teksteve shkollore të klasave 1, 2, 3, 5, 10, 11 dhe 12 të sistemit arsimor parauniversitar për vitin shkollor 2025-2026. **(5 IAP)**
- Inspektim institucioneve arsimore private parauniversitare për plotësimin e kërkesave ligjore në veprimtarinë e institucionit arsimor parauniversitar privat. **(8 IAP)**

- Inspektim institucioneve arsimore private parauniversitare për plotësimin e kërkesave ligjore në veprimtarinë e institucionit arsimor parashkollor privat. **(5 kopshte) ;(Autorizime nga AKAP)**
- Inspektim i IAP-ve për verifikimin e zbatimit të kriterëve ligjore mbi ngritjen e organeve kolegjiale në shkollë. **(7 IAP)**
- Inspektim i IAP –ve për verifikimin e zbatimit të kriterëve ligjore mbi hartimin dhe zbatimin e planit afatmesëm, planit vjetor dhe raportit vjetor. **(8 IAP, nga të cilat 2 IAP private)**
- Vlerësime bazuar në ankesa **(11 IAP);**

Verifikim dhe trajtim i 21 ankesa, etj.

Inspektimet në arsimin bazë dhe AML

Muaji	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nëntor	Dhjetor
Inspektime IAP-jopublike	4						1	3		2		
Inspektime IAP-publike	3		5	5		2			8	8	2	4
Inspektime ZVAP	3			3							2	
Shqyrtime ankesash	1			2	3	2				2		1
Kopshte					5							

Për vitin 2025 janë realizuar inspektime, dhe vlerësime dhe sipas planifikimit vjetor dhe të orientuara nga MA. Sektori I inspektimit në AMU/AMLAKAP DRAP ka kryer **71** vlerësime dhe inspektime gjithsej dhe janë vendosur 10 dënime administrative për shkolla, 4 publike dhe 6 private si dhe propozuar 5 masa disiplinore për drejtor institucione publike, 2 psikolog dhe 1 mësues.

Institucioni DRAP Fier	Total	Monitorime	Inspektime	Vlerësime	Dënime administrative	Masa disiplinore të propozuara
Sektori i inspektimit AMU/AML	71	37	60	14	10 4 publike 6 private	5 drejtues IAP publike, 2 psikolog, 1 mësues
Total						

Në vitin 2025, në zbatim të funksioneve të shtuara pas ristrukturimit, edhe sektori i monitorimit, vlerësimit të kurrikulës dhe zhvillimit profesional ka planifikuar dhe realizuar 37 monitorime të ZVAP-ve dhe institucioneve arsimore brenda rajonit të DRAP Fier (pra, këtu nuk përfshihen

11 vlerësimeve të kryera nga Sektori i Inspektimit në Arsimin Bazë dhe AML i shtohen edhe 3 vlerësime rastesh nga sektori i monitorimit, vlerësimit të kurrikulës dhe zhvillimit profesional, në përfundim të të cilave në 1 rast është propozuar masë disiplinore për drejtuesin e shkollës. Këto monitorime janë kryer në 12 nga 13 ZVAP-të rajonit tonë, prej muajit shkurt deri në dhjetor 2025, krahas angazhimit të specialistëve të kurrikulës në monitorime në grupet e ngritura nga KAP jashtë DRAP Fier.

Shpërndarja e numrit të inspektimeve, monitorimeve dhe vlerësimeve gjatë vitit 2025 sipas muajve, si më poshtë vijon:

Për muajin **janar 2025** janë kryer **6** inspektime.

Tematikat janë fokusuar kryesisht si më poshtë vijon:

- Inspektim i **3** ZVAP për masat e marra për arsimimin e fëmijëve më AK;
- Inspektim i **3** IAP-ve për zbatimin e ligjshmërisë në procedurat e ndjekura nga IAP për masat e marra për organizimin e praktikës profesionale;

Për muajin **shkurt 2025** janë kryer **4** inspektime në IAP private dhe **1** vlerësim ankese. Janë vendosur **3** dënime administrative (Paralajmërim) dhe **1** masë disiplinore për drejtues të IAP publike.

Tematikat janë fokusuar kryesisht si më poshtë vijon:

- Inspektim i **4** IAP-ve privat, për plotësimin e kërkesave ligjore në veprimtarinë e institucionit parauniversitar privat;
- Verifikim dhe trajtim i **1** ankese .

Për muajin **mars 2025** është kryer **5** inspektime dhe nuk ka dënime administrative. Tematikat janë fokusuar kryesisht si më poshtë vijon:

- Inspektim i **5** IAP-ve publike, për verifikimin e zbatimit të kriterëve ligjore mbi ngritjen e organeve kolegjinale në shkollë (komisioni i etikës, disiplinës, shëndetit);

Për muajin **prill 2025** janë kryer **8** inspektime dhe **2** vlerësime ankesash. Nuk ka dënime administrative, por ka **2** rekomandime për masë disiplinore.

Tematikat janë fokusuar kryesisht si më poshtë vijon:

- Inspektim i **5** IAP-ve, për përzgjedhjen, shpërndarjen dhe shitjen e teksteve shkollore të klasave 1, 2, 3, 5, 10, 11 dhe 12 të sistemit arsimor parauniversitar për vitin shkollor 2025-2026;
- Inspektime i **3** ZVAP mbi zbatimin e ligjshmërisë në procedurën e ndjekur nga ZVAP për masat e marra për organizimin e praktikës profesionale për profesionin e rregulluar të mësuesit;
- Verifikim dhe trajtim i **2** ankese në IAP publike.

Për muajin **maj 2025** janë kryer **5** inspektime nga AKAP dhe DRAP dhe **3** verifikim dhe trajtim ankese. Janë vendosur **4** dënime administrative dhe **2** propozim masë disiplinore për drejtues në IAP publike.

Tematikat janë fokusuar kryesisht si më poshtë vijon:

- Inspektim i **5** kopshteve private, për plotësimin e kërkesave ligjore në veprimtarinë e institucionit parashkollor privat;
- Verifikim dhe trajtim i **3** ankesave në IAP publike.

Për muajin **qershor 2025** janë kryer **2** inspektime dhe **2** verifikime ankese. Nuk ka masa administrative dhe disiplinore.

Tematika janë fokusuar kryesisht si më poshtë vijon:

- Inspektim i **2** IAP-ve publike, për numrin e nxënësve për klasë dhe ngarkesën mësimore të punonjësve arsimore në institucionet e arsimit parauniversitar;
- Inspektim i **13** kopshteve, për zbatimin e kriterëve ligjore mbi hatimin dhe zbatimin e planit afatmesëm, plani vjetor dhe raporti vjetor.

Për muajin **korrik 2025** është kryer 1 inspektim, është vendosur **1** dënim administrative.

Tematikat janë fokusuar kryesisht si më poshtë vijon:

